

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**OBJEKTI:** “Shërbim lyerje dhe mirëmbajtje ndërtesash për Spitalin Rajonal Korçë, për periudhën 2 - vjeçare 2024 - 2025 (Marrëveshje Kuadër)”.

**FONDI LIMIT :** 13,556,837.13 (trembëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

### **PËRMBAJTJA**

Përshkrimi i punimeve që do të kryhen në objektet e sipërpërmendura.

### **SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME**

- 1.1. Specifikime të përgjithshme
  - 1.1.1 Njësitë matëse
  - 1.1.2 Grafiku i punimeve
  - 1.1.3 Punime të gabuara
  - 1.1.4 Tabelat njoftuese
- 1.2. Dorëzimet tek Supervizori
  - 1.2.1 Autorizimet me shkrim
  - 1.2.2 Sigurimi i vizatimeve të detajeve
  - 1.2.3 Dorëzimet tek supervizori

### **SEKSION I. Punime murature tulle**

I.1 Murr tulle deri 3m lartësi me llaç të përzier M 25

### **Seksioni II. Punime tavani dhe suvatimi**

- II.1 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç përzier M 25
- II.2 Veshje tavani me kartonxhes
- II.3 Plintuse pllakë grez
- II.4 Veshje me pllakë majolike
- II.5 Patinim murri allçi (stuko)
- II.6 Patinim tavani allçi (stuko)
- II.7 Veshje fasade me pllaka mermeri

### **Seksioni III. Nënshtrës dhe shtrës në territorin e ndërtesave**

III.1 Shtresë me pllaka grez porcelanato

### **Seksioni IV. Punime bojatisje**

- IV.1 Bojë vaji Sipërfaqe druri
- IV.2 Bojë vaji sipërfaqe metalike
- IV.3 Bojë hidroplastike cilësi e lartë

### **Seksioni V. Punime shtresash 2**

V.1 Shtresë me pllaka mermeri  $t=2\text{cm}$

## Seksioni VI. **Punime betoni dhe b/a**

VI.1 Mur betoni C 16/20

## Seksioni VII. **Punime murature guri**

VII.1 Mur guri themel e xokol me llaç të përzier M 15

## Seksioni VIII. **Ndërtimi i veprave të artit+kanalizime**

VIII.1 Ndërtim puseta betoni  $H=2.5-3\text{m}$ ,  $D=1\text{m}$  + kapak gize

## Seksioni IX. **Punime hidroizolimi dhe çatite**

IX.1 Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze

IX.2 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat  $\varnothing 100$

IX.3 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33cm

IX.4 Shtresë lluster çimento 1:2  $t = 20\text{ mm}$

## Seksioni X. **Punime dyer dritare**

X.1 F V dritare d/alumini plastike me dopio xham

X.2 Dyer d/alumini dopio xham

## Seksioni XI. **Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje**

XI.1 F.V saracineska bronzi  $\varnothing 1/2\text{ ''} = 15\text{ mm}$

XI.2 F.V saracineska bronzi  $\varnothing 1\ 1/2\text{ ''} = 40\text{ mm}$

XI.3 F.V bide porcelain

XI.4 F.V tub xingato dhe rakorderi  $\sim 1\text{ ''}$

XI.5 F.V lavaman porcelain

XI.6 F.V WC allafrenga

XI.7 F V bolier 80 litër, ujë të ngrohtë

XI.8 F V bolier 12 litër, ujë të ngrohtë sanitar

XI.9 F.V piletë dyshemeje  $\varnothing 50$

XI.10 F.V Saraçineskë PPR 1/2''

XI.11 F.V Saraçineskë PPR 3/4''

## Seksioni XII. **Instalime për ndriçim**

XII.1 F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T

XII.2 F.V priza shuko brenda murit 2 fazorë 25 A

- XII.3 F.V Çelesa e priza 10 A
- XII.4 F.V. Ndriçues tavanor fluoreshentë 1x18w
- XII.5 F.V Automat sekondar me 4 vende
- XII.6 F.V Portollampa norm 10 A
- XII.7 F.V kuadër ndriçimi
- XII.8 F.V. Ndriçues fluoreshent 1x40w.IP65
- XII.9 F.V Siguresa ~ 25 A

## **SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME**

### 1.1 Specifikime të përgjithshme

#### 1.1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

#### 1.1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

#### 1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

#### 1.1.4 Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

### 1.2 Dorëzimet te Supervizori

### 1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

### 1.2.2 Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

#### Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

## Seksioni I. **Punime murature tulle**

### I.1 Murr tulle deri 3m lartësi me llaç të përzier M 25

Muratura të jetë me tulla të plota 12 cm dhe h=3m me llaç bastard m-25 .Për m3; tulla te plota 424 copë llaç 0.19m<sup>3</sup> çimento 400 dhe ujë.

## Seksioni II. **Punime tavani dhe suvatimi**

### II.1 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç përzier M 25

Sistemim i sipërfaqeve të pastruara nga suvatimet e dëmtuara, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo

detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë.

Sprucim i mureve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m ), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

## II.2 Veshje tavani me kartonxhes

Pllakat e gipsit do të përoren për riparimin e tavanëve prej gipsi të dëmtuar. Përdorimi i kartongipsit lejohet kryesisht në ambiente të thata, por rrallë edhe në ambiente me lagështirë. Në rast të përdorimit në ambiente me lagështirë, pllakat e gipskartonit duhet të kenë shenjë të veçantë nga prodhuesi, me të cilën lejohet përdorimi i tyre në ambiente të tilla.

Metodat e riparimit të tavanëve prej gipskartoni duhet të merren nga prodhuesi.

## II.3 Plintuse pllakë gres

Plintusa me pllakë gres 8 – 10 cm lartësi dhe 1.5 cm të trasha. Vendosen me kollë dhe me llaç në proporcionet e mëposhtme për m<sup>2</sup>: 4 kg çimento (M 400), 0.005m<sup>3</sup> rërë e larë dhe ujë duke përfshirë dhe pastrimin dhe gjithë kërkesat për një punë me cilësi të lartë.

## II.4 Veshje me pllakë majolike

Për sa i takon ngjitjes si pllakave me llaç ose kollë duhet ti përmbaheni këtyre kushteve. Baza në të cilën ngjiten pllakat e tipeve të ndryshme duhet të jetë e pastër nga pluhuri dhe të jetë e qëndrueshme. Trashësia e llaçit duhet të jetë jo më pak se 15mm.

## II.5 Patinim murri allçi (stuko)

Patinaturë murri realizohet me stuko, çimento dhe gëlqere të cilësisë së lartë mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje gëlqere 3kg për m<sup>2</sup>.

## II.6 Patinim tavani allçi (stuko)

Patinaturë tavani realizohet me stuko, çimento dhe gëlqere të cilësisë së lartë mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje gëlqere 3kg për m<sup>2</sup>.

## II.7 Veshje fasade me pllaka mermeri

# Seksioni III. Nënshtrësia dhe shtrësia në territorin e ndërtesave

## III.1 Shtresë me pllaka grez porcelanato

Për sa i takon ngjitjes si pllakave me llaç ose kollë duhet ti përmbaheni këtyre kushteve. Baza në të cilën ngjiten pllakat e tipeve të ndryshme duhet të jetë e pastër nga pluhuri dhe të jetë e qëndrueshme. Trashësia e llaçit duhet të jetë jo më pak se 15mm.

## Seksioni IV. **Punime bojatisje**

### IV.1 Bojë vaji Sipërfaqe druri

Lyerja me bojë vaji sipërfaqe druri bëhet për dy arsye;

Për arsye dekorative si dhe për të rritur qëndrueshmërinë ndaj lagështirës. Materialet që përdoren për lyerjen e sipërfaqeve të drurit duhet të plotësojnë të dyja këto kërkesa.

### IV.2 Bojë vaji sipërfaqe metalike

Sipërfaqet metalike të dëmtuara do të riparohen duke i lyer me bojë me përmbajtje të rëshirave alkide e cila ka veti shumë të mira qëndrueshmërie dhe shkëlqimi, për përdorim të brëndshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike, duke siguruar një mbrojtje që ruan shkëlqimin, me specifikime teknike si më poshtë:

Densiteti 1.2-1.22kg/lit ( Sipas ISO 2811ose ekuivalent)  
Viskoziteti 70-75 KU (Sipas ASTM D 562, 25°C ose ekuivalente)  
Shkëlqimi 90 units @ 60\* ( ISO 2813 ose ekuivalent)  
Mbulimi (ne sip. suvaje) 15-17 m<sup>2</sup>/Litër  
Temperatura e aplikimit +5<sup>o</sup>C- 38<sup>o</sup> C  
Përmbajtja e përbërësve organikë të avullshëm (VOC) < 500 gr/Litër

### IV.3 Bojë hidroplastike cilësi e lartë

Lyerja e ambienteve të brendshme do të bëhet me bojë me aftësi të lartë mbulimi dhe qëndrueshmërie në larje, ekologjike dhe antimikrobikale, pa përmbajtje amoniaku, pa erë për përdorim të brendshëm. Boja të jetë e tillë që të parandalojë rritjen e mikrobeve, duke qënë e përshtatshme për përdorim në ambiente spitalore. Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të mbushjes dhe stukimi i riparimeve. Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Pasi të stukohen sipërfaqet përpara lyerjes do të trajtohen me primer. Prajmeri është me përbërje silikoni akrilik, me bazë uji gjysëmtransparent dhe ekologjik. Është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtëme, me veti hidroizoluese dhe nuk përmban amoniak apo substanca të tjera të rrezikshme, siç janë hidrokarburet aromatike, metale të rënda.

Boja përpara përdorimit duhet të hollohet me ujë deri në masën 10%. Ngjyrat do të përcaktohen nga autoriteti kontraktor.

Të dhënat teknike të bojës:

Viskoziteti: 105 -110 ± 10 KU (ASTM D 562, 25° C) ose ekuivalent

Densiteti: 1,40 – 1,48 ± 0,02 Kg/L (ISO 2811) ose ekuivalent

Aftësia mbuluese: 11 - 13 m<sup>2</sup> /L

Boja duhet të përmbushë standartet:

Standartin “EU ECOLABEL” (Ekologjik) sipas Direktives Europiane 2014/312/EEC <sup>6</sup>ose ekuivalent.

Standartin Antibakteriale sipas ISO 22196 ose ekuivalent.

## Seksioni V. **Punime shtresash 2**

### V.1 Shtresë me pllaka mermeri $t=2\text{cm}$

Riparimi për pllakat e dëmtuara duhet të bëhet në këtë mënyrë: - Pllakat e mermerit të dëmtuara duhet të hiqen me gjithë llaçin në një trashësi të paktën 3cm. Pastaj duhet që vendi të pastrohet dhe të lahet me ujë me presion. Plakat e reja të jenë me të njëjtën ngjyrë dhe me dimensione të njëjta si pllakat egzistuese.

## Seksioni VI. **Punime betoni dhe b/a**

### VI.1 Mur betoni C 16/20

Betoni duhet të jetë i M-300. Duhet të hidhet në shtresa të holla dhe të vibruara mirë, me dozim sipas M-300 inert, duke përfshirë hekurin e armaturës, kallëpët, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër me mjeshhtëri për mbarimin e punës. Hedhja e betonit në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet. E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij procesi. Matja do të jetë më m<sup>3</sup>.

## Seksioni VII. **Punime murature guri**

### VII.1 Mur guri themel e xokol me llaç të përzier M 15

Muratura të jetë me tulla të plota 12 cm dhe  $h=3\text{m}$  me llaç bastard m-25 .Për m<sup>3</sup>; tulla te plota 424 copë llaç 0.19m<sup>3</sup> çimento 400 dhe ujë.

## Seksioni VIII. **Ndërtimi i veprave të artit+kanalizime**

### VIII.1 Ndërtim puseta betoni $H=2.5-3\text{m}$ , $D=1\text{m}$ + kapak gize

Konsiston në kryerjen e punimeve lidhur me mirëmbajtjen, pastrimin dhe riparimin e defekteve në këto puseta, si dhe ndërtimin e pusetave të reja.

## Seksioni IX. **Punime hidroizolimi dhe çatite**

### IX.1 Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze

Çatia është me material druri të lehtësuar dhe mbulesa me tjegulla marsejeze. I gjithë materiali i drurit është me seksion katror, sipas shënimeve teknike, i stazhionuar dhe me përmbajtje lagështiebrenda normave teknike. Materiali i drurit është i mbuluar me letër katerma me dy duar për të eliminuar pikimet nga shiu mbi taracën ekzistuese.

Punimet do të konsistojnë në riparimet e çatisë, duke përfshirë zëvendësimin e trarëve të dëmtuar nga lagështia ose nga parazitët, si dhe zëvendësimin e tjegullave marsejeze të dëmtuara nga agjentët atmosferikë sipas kushteve teknike.

## IX.2 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100

Ulluqet horizontale janë me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale janë disa prej materiali plastik dhe disa me llamarinë xingato me trashësi 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes dhe i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Punimet do të konsistojnë në zëvendësimin e seksioneve të dëmtuara të ulluqeve dhe hallkave, duke i zëvendësuar me seksione dhe hallka të reja dhe të montuara sipas kushteve teknike.

## IX.3 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33cm

Ulluqet vertikalë janë për shkarkimin e ujrave të çatave dhe taracave prej llamarinë prej çeliku të xinguar, me trashësi 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluqet vertikale prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe çatie nga 30 deri në 60 m<sup>2</sup>. Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrata e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 m<sup>2</sup>. Ullukët janë vendosur në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 2 m. Ujrat e taracës që kalojnë në tubat vertikale mblidhen nëpërmjet një pjate prej llamarine të xinguar, i riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3mm, të vendosur në mënyrë të tërthortë, ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, e cila lidhet me kasetën e shkarkimit sipas udhëzimeve në projekt. Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, është prej PVC dhe e mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90 gradë. Punimet do të konsistojnë në zëvendësimin e seksioneve dhe qaforeve të dëmtuara të ulluqeve, duke i zëvendësuar me seksione dhe qafore të reja dhe të montuara sipas kushteve teknike.

## IX.4 Shtresë lluster çimento 1:2 t = 20 mm

Riparimi i dyshemesë me lustër çimento duhet bërë në këtë menyrë; - Më së pari duhet të lokalizohen pjesët e dëmtuara të lustër çimentos. Pastaj duhet që në ato pjesë që ka dëmtime të vizatohet një katërkëndësh dhe dyshemeja të pritët deri në një thellësi prej të paktën sa është thellësia e dyshemesë. Ajo pjesë e vizatuar duhet të hiqet me mjete mekanike dhe vendi të pastrohet nga pluhuri si dhe të lahet në ujë me presion. Para se të hidhet në gropën e hapur pjesët anësore të saj lyhen me një solucion i cili ndihmon ngjitjen e lustër çimento me shtresën e betonit.

## Seksioni X. **Punime dritare**

### X.1 F V dritare d/alumini plastike me dopio xham

Furnizimi dhe vendosja e dritareve përbëhet nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standateve Eurpiane EN-573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Korniza fikse e dritares do ketë një dimension 61-90 mm. Ato janë të siguruar me elementë që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit si dhe në pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares.

### X.2 Dyer d/alumini dopio xham



Dyert e brendshme prej duralumini përbehet nga: - Kasa fikse në forme profilesh tubolare prej duralumini me thellësi 61-90 mm të cilat sigurohen me element të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve. Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë jo më e vogël se 25 mm larg murit.

## Seksioni XI. **Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje**

### XI.1 F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm

Saracineskat janë pajisje të vecanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes së tubacionit të ujit. Saracineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit sferë ose me portë, me bashkim me filetimit ose me fllanxhë.

### XI.2 F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm

Saracineskat janë pajisje të vecanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes së tubacionit të ujit. Saracineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit sferë ose me portë, me bashkim me filetimit ose me fllanxhë.

### XI.3 F.V bide porcelain

### XI.4 F.V tub xingato dhe rakorderi ~ 1 "

Konsiston në zëvendësimin e seksioneve të dëmtuara të rrjetit të ujit të pijshëm i cili është me tuba xingato, me tuba të rinj xingato, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre në rrjetin e ujit të opijshëm të bëhet sipas kushteve teknike si dhe zëvendësimin e rakorderive xingato të dëmtuara të rrjetit të ujit të pijshëm, me rakorderi xingato të reja, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre në rrjetin e ujit të opijshëm të bëhet sipas kushteve teknike.

### XI.5 F.V lavaman porcelain

Konsiston në zëvendësimin e lavamanëve të dëmtuar, me lavamanë të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike

### XI.6 F.V WC allafrenga

Konsiston në zëvendësimin e WC Allafrënga importi të dëmtuar, me WC Allafrënga importi të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike.

### XI.7 F V boiler 80 litër, ujë të ngrohtë

Konsiston në zëvendësimin e boilerëve 80 litra të dëmtuar, me boiler 80 litra të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike.

### XI.8 F V boiler 12 litër, ujë të ngrohtë sanitar

Konsiston në zëvendësimin e boilerëve 12 litra të dëmtuar, me boiler 80 litra të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike.

## XI.9 F.V piletë dysHEMEJE Ø 50

Për shkarkimin e ujerave të dysHEMEVE do të përdoren pileta të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e cilesisë sipas standartit ISO dhe prEN12201. Piletat mund të jenë me material plastik, inoksi ose bronxi.

## XI.10 F.V Saraçineskë PPR 1/2"

Saracineskat janë pajisje të vecanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes së tubacionit të ujit. Saracineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit sferë ose me portë, me bashkim me filetim ose me fllanxhë.

## XI.11 F.V Saraçineskë PPR 3/4"

Saracineskat janë pajisje të vecanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes së tubacionit të ujit. Saracineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit sferë ose me portë, me bashkim me filetim ose me fllanxhë.

## Seksioni XII. Instalime për ndriçim

### XII.1 F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T

Konsiston në zëvendësimin e prizave të dëmtuara me prize të reja, të cilat duhet të jenë të tipit me tokëzim dhe me mbrojtje ndaj perdorueseve. Prizat ashtu si edhe çelësat mund të jenë të tipit që montohen nën suvatim ose mbi suvatim. Prizat janë të specifikuar sipas përdorimit në:

- Priza tensioni njëfazore.
- Priza tensioni trefazore.
- Priza kompjuterike, telefonike, televizive.

Prizat e tensionit njëfazore kanë 1pin për fazën, 1pin për nulin dhe 1pin për tokëzimin.

Prizat e tensionit trefazore kanë 3pine për fazën, 1pin për nulin dhe 1pin për tokëzimin. Te gjithë prizat duhet të jenë të tipit 16A/250V/3-pin, 16-20-25A/380V-5pine, dhe te montohen nën sipërfaqe e suvatimit. Ato duhet të kenë një ngjyrë që të shkojë me ngjyrën e kapakeve të kutive dhe çelësave të ndriçimit. Te gjithë prizat, që janë parashikuar për furnizimin me energji elektrike të kompjuterve në zyrë, duhet të jenë të tipit 16A/250V/3-pin dhe te montohen nën sipërfaqen e suvatimit. Te gjithë prizat duhet të jenë një tip i ngjashëm i specifikuar si më poshtë:

- Playbus Range, me ndarës sigurie 250/400V, 1P-16A, 20A, 25A, 2P-16, 20, 25A.
- Playbus Range, me ndarës sigurie 250v, 4P-16A, 20, 25A

Prizat e rrjetit kompjuterik e telefonik duhet të jenë me 8 pine, e 4pine, me kapak për mbrojtje nga demtimet e pluhurat. Ato duhet të kenë një ngjyrë që të shkojë me ngjyrën e kapakeve të kutive dhe çelësave të ndriçimit dhe sipas rekomandimit të arkitektit ose supervizorit.

### Priza Bivalente

- Tensioni: 250 V AC
- Diametri i spinave: Ø4/5mm
- Tipi i Prizes: P11/17
- Rryma: 2P+E - 16 A
- Rezistenca në tensionin e testit: 2000V në 50Hz për 1 minute

- Rezistenca e izolimit: >5MΩ
- Standarti: IEC60844-1, CEI 23-50-II Ed.2007 ose ekuivalent
- Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot e perdredhshem: 0,75-2x4 mm<sup>2</sup>
- Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot solid: 0,5-2x5 mm<sup>2</sup>
- Nr. i moduleve: 1

## XII.2 F.V priza shuko brenda murit 2 fazorë 25 A

Konsiston në zëvendësimin e prizave të dëmtuara me prize të reja, të cilat duhet të jenë të tipit me tokëzim dhe me mbrojtje ndaj perdorueseve. Prizat ashtu si edhe çelësat mund të jenë të tipit që montohen nën suvatim ose mbi suvatim. Prizat janë të specifikuar sipas perdorimit në:

- Priza tensioni njëfazore.
- Priza tensioni trefazore.
- Priza kompjuterike, telefonike, televizive.

Prizat e tensionit njëfazore kanë 1pin për fazën, 1pin për nulin dhe 1pin për tokëzimin.

Prizat e tensionit trefazore kanë 3pine për fazën, 1pin për nulin dhe 1pin për tokëzimin. Te gjithë prizat duhet të jenë të tipit 16A/250V/3-pin, 16-20-25A/380V-5pine, dhe te montohen nën sipërfaqe e suvatimit. Ato duhet të kenë një ngjyrë që të shkojë me ngjyrën e kapakeve të kutive dhe çelësve të ndriçimit. Te gjithë prizat, që janë parashikuar për furnizimin me energji elektrike të kompjuterve në zyrë, duhet të jenë të tipit 16A/250V/3-pin dhe te montohen nën sipërfaqen e suvatimit. Te gjithë prizat duhet të jenë një tip i ngjashëm i specifikuar si më poshtë:

- Playbus Range, me ndarës sigurie 250/400V, 1P-16A, 20A, 25A, 2P-16, 20, 25A.
- Playbus Range, me ndarës sigurie 250v, 4P-16A, 20, 25A

Prizat e rrjetit kompjuterik e telefonik duhet të jenë me 8 pine, e 4pine, me kapak për mbrojtje nga demtimet e pluhurat. Ato duhet të kenë një ngjyrë që të shkojë me ngjyrën e kapakeve të kutive dhe çelësve të ndriçimit dhe sipas rekomandimit të arkitektit ose supervizorit.

### Priza Shuko

- Tensioni: 250 V AC
- Rryma: 2P+E - 16 A
- Tokëzimi: Në krahe dhe në qender
- Diametri i spinave: Ø4/4.8/5mm
- Tipi i Prizes: P40
- Rezistenca në tensionin e testit: 2000V në 50Hz për 1 minute
- Rezistenca e izolimit: >5MΩ
- Standarti: IEC60884-1 ose ekuivalent
- Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot e perdredhshem: 0,75-2x4 mm<sup>2</sup>
- Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot solid: 0,5-2x5 mm<sup>2</sup>

## XII.3 F.V Çelësa e priza 10 A

Konsiston në zëvendësimin e çelësve të ndriçimit të dëmtuara dhe jashtë funksionit me çelësa të thjeshtë 10 A, duke i montuar në kuti brenda murit, sipas kushteve teknike.

## XII.4 F.V. Ndriçues tavanor fluoreshentë 1x18w

Konsiston në zëvendësimin e ndriçuesve tavanorë të njëjtë me ato të demtuara dhe zëvendësimin e tyre sipas kushteve teknike.

#### XII.5 F.V Automat sekondar me 4 vende

Konsiston në zëvendësimin e automatesve kryesorë me katër vende të linjës elektrike të dëmtuara dhe jashtë funksionit me automatë kryesorë me katër vende të rinj të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

#### XII.6 F.V Portollampa norm 10 A

Konsiston në zëvendësimin e portollambave të zakonshme 10A të dëmtuara dhe jashtë funksionit me portollamba të zakonshme 10A të rinj dhe të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

#### XII.7 F.V kuadër ndriçimi

Konsiston në ndërimin e kuadrove të ndriçimit të dëmtuara dhe jashtë funksionit me kuadër të rinj të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

#### XII.8 F.V. Ndriçues fluoreshent 1x40w.IP65

Konsiston në ndërimin e ndriçuesve tavanorë 40w të dëmtuara dhe jashtë funksionit me ndriçues të rinj të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

#### XII.9 F.V Siguresa ~ 25 A

Konsiston në zëvendësimin e siguresave 25A të linjës elektrike të dëmtuara dhe jashtë funksionit me siguresa 25A të reja të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.